



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANE

***KËRKESË PËR NDIHMË JURIDIKE
DREJTUAR AUTORITETIT GJYQËSOR KOMPETENT TË SPANJES***

Prokuroria prane Gjykares se Shkalles se Pare Tirane, u kërkon autoriteteve të Drejtësisë Spanjolle, dhënien e ndihmës juridike në kuadër të procedimin penal Nr 6607, dt 09.10.2020, për veprimet penale të “Shitblerja e paligjshme e organeve”, të parashikuar nga neni 89/a të K.Penal.

Përmbledhje e fakteve objekt hetimi lidhur me procedimin penal ;

Me datë 27.05.2020, rreth orës 08.00 është marrë njoftim nga Salla Operative Tirane, për kryerjen e veprimeve prane IML-se Tirane, për kufomën e të ndjerit shtetasit Saimir Sula.

Nga veprimet hetimore të kryera është bërë kqyrja e kufomes, si dhe është përpiluar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko- ligjorë i kufomes.

Nga deklaratimet e marra shtetases Manushaqe Sula (*halla e të ndjerit Saimir Sula*), deklaroi se është njoftuar me datë 09.05.2020, nga motra e të ndjerit shtetasja Majlina Sula, se i ndjeri Saimir Sula (*datelindja 17.12.1988*) kishte ndërruar jetë në një nga Spitalet në Spanjë.

Në deklaratimin e saj shtetasja Majlina Sula ka shpjeguar se i ndjeri vëllaj i saj shtetasi Saimir Sula ka ndërruar jetë në Hospital Del Mar, me adresë “Passeig Maritim de la Barceloneta Nr 25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelone Spanjë.

Heren e fundit që i ndjeri vëllaj i saj ka shkuar në Spanjë, ka qenë në muajin Shkurt të vitit 2020, gjendja e tij shëndetësore ishte e mirë. Qëllimi i vajtjes në Spanjë të të ndjerit, ishte që të punësohej atje. Ajo sqaroi se vëllaj i saj mjekohej me antipsikotik edhe diazepam për gjumë, ex abuzues i substancave narkotike, dhe me këtë mjekim në vitin e fundit e ka marrë me shpejtë, por muajit e fundit e ka marrë rregullisht.

Pra ndërmjet Muajit Prill dhe Maj të vitit 2020, psikiatria Ana Martin, mjekë psikiatër prane Spitalit Sant Pau, në Barcelonë, Spanjë e ka ndjekur si rast duke shkuar çdo ditë në shtëpi, pra duke e ndjekur rregullisht me problematiken që kishte vëllaj. I ndjeri vëllaj i saj, ka qenë përdorues i lendeve narkotike, por vitin e fundit nuk konsumonte me lende narkotike, por kishte filluar mjekimin e nevojshëm, pra nuk konsumonte me.

Persa i perket ngjarjes se ndodhur me date 09.05.2020 , ajo me date 08-05-2020, e ka shoqeruar vellajn e saj te ndjerin Saimir Sula, ne spitatin e quajtur Hospital Del Mar, me adrese “Passeig Maritim de la Barceloneta Nr 25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelone Spanje, pasi me date 08.05.2020 kishte temperature , rreth 37.5, apo 38 dhe rreth ora 22;30, ka lajmeruar ambulancen per ti bere nje prove/ test Covid 19. E ka shoqeruar me ambulance ne Hospital Del Mar ne Barcelona, i bejne proven e virusit, por e cila rezultoj negative. Ne karteles e tij shkruhet qe tac i pulmonit eshte mire, edhe nuk evidencohen shenja te pneumonise, por hyri ne spital me dyshimin se mund te kishte Covid 19.

Te nesermen ne mengjes rreth ores 12:08, eshte telefonuar nga spitali, nga numri i spitalit 0034-649288801, dhe infermierja e telefonon qe Majlina te njoftonte vellajn e saj qe spitali do e dergonte per ti bere nje prove tac i mushkerise, dhe pacienti te rrij i qete. Pas kesaj bisede me infermieren ajo komunikon me vellajn e saj, dhe e ve ne dijeni se spitali do ta dergonte per te bere nje prove te mushkerive dhe vellaj i thote duke qare e bertitur, “Majlinda ketu po me marrin shpirtit, i thuaj infermieres te me liroje pak se po vdes, ok i them po vij aty, per pak minuta”.

Pas kesaj bisede me vellajn, sipas shjegime te saj ajo eshte nisur menjeher per ne spitali, shkon ne spital tek recepsioni kerkon te flas me doktoret, i pyet nese ato kishin dijeni per testin per Covid 19 dhe ju kerkon te me nxjerrin vellajn nga spitali, pasi semundja e tij eshte se ai ka alucinacione, edhe ka shume frike nga njerezit, ju lutem me lerni te hyj sa te shohi nje here sepse e dije qe ai do te qetesohet, me thone qe per shkak te situates se Covid 19, nuk mund te hyj ne spital .

Me japin nje numer kontakti dhe konkretishte numrin 0034-932209586, per te kerkuar informacion mbi paciente, ora diku do kete qene 15:00, e dates 09.05.2020 le nje mesazh vocal duke thene “*jam familiar*”, me telefoni ju lutem. Pas dy oresh me telefonojne dhe me thone qe pacienti eshte mire, dhe qe prova Covid 19, eshte negative.

Akoma ndodhesha ne hyrje te spitalit , i lutem vajzes qe po komunikoj me te ne telefon, te komunikonte me mjekun, ti thote qe duhet te lexoje kartelat e vellait tim, te kene parasysh psikozen qe ka, ai ka shume frike nga njerezit, i lutem vajzes te me kaloj mjekun, ose ti coj mesazhin tim. Kam insistuar nepermjet telefonit qe te merja vellajn me vete, me qellim qe te kujdesesha vete ne shtepi. Pasi arsyeja e vajtjes ne spital me date 08.05.2020, ka qene pikerishte ajo pak temperature qe kishte vellaj dhe tesi doli negative dhe ajo prandaj ka insistuar per ta marre me vete. Vellai merrte mjekim ne shtepi, ne lidhje me problemet (halucinacionet) edhe mjekja Ana Martin Psikiatre, shkonte nje dite po nje dite jo, e shikonte ne shtepi. Meqe Covid 19, doli negative, ska arsye pse te rrije aty, te lutem kontrolloni kartelat.

Rreth ores 18:00 me telefonon doktoresha Irene Petit, me thote hajde ne spital, shkoj atje duke menduar do mare vellain ne shtepi. Me thone se i pushoj zemra, se dime ndoshta kemi bere ndonje gabim, por do te cohet per autopsi ne mjeksi ligjore ne Barcelone.

Pas ngjarjes ka kerkuar kopje te dokumentacionit pra te karteles klinike te ndjerit vellajt te saj Saimir Sula dhe ne kartelen klinike “ *shkruhet i berem nje ampul haloperidol i pushoj zemra ne pak sekonda, nuk dije arsyen pse*”.

Me date 11 apo 12 Maj 2020 ne Mjekesine Ligjore ne Brçelaone, ka marr kopje te autopsies preliminare,ku nuk percaktohet definitivisht shkaku i vdekjes, po pritet per nje autopsi definitive, thone qe jane mar mostra te mushkrise melcise, zemres. Edhe priten analizat e toksike.Akoma sot ne 26.10.2020 jemi ne pritje. Pra nga ana e tyre nuk ka akoma pergjigje perfundimtare ne lidhje me shkaku e vdekjes. Ajo mendoj qe shkaku i vdekjes se te ndjerit vellajt te saj ka qene neglizhenca e kujdesit mjekesor te stafit mjekesor ne Spitalin Hospital Del Mar, me adrese "Passeig Maritim de la Barceloneta Nr 25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelone Spanje. Ajo eshte ne pritje marrjes se autopsesi definitive dhe do i kallazoj penalishte personelin mjekesor te spitalit te Spanjes ne autoritetet perkatese ne Spanje.

Eshte e bindur se neglizhenca e personelit mjekesor ne Spanje, kane sjelle si pasoje humbjen e jetes te ndjerit Saimir Sula. Kjo ka qene arsyeja qe ajo ka kerkuar nje autopsi te dyte ne Tirane. Eshte vene ne dijeni nga ana e organit te akuzes per konkluzionet e arritura ne aktin e ekspertimit Mjeko-Ligjor Nr 540, Regj , date 07.10.2020, pra mungesa e zemres te ndjerit Saimir Sula. Duke lexuar autopsine preliminare te Brçelones jane pasqyruar se jane marre mostra te mushkrise, melcise, zemres, per analiza toksike, por absolutisht nuk ka dijeni te mungeses se zemres.

Ajo thekson faktin se nga ana e saj dhe e familjareve te tyre, nuk eshte bere ne menyre kategorike, ndonje dhurim "zemre", apo te jete dhene ndonje autorizim per marrjen e organeve te te ndjerit vellajt te saj.

Ne funksion te hetimit eshte bere kqyrja e kufomes, ne ambientet e morgut te I.M.L-se,Tirane ku nga kqyrja nuk jane konstatuar shenja dhune/ demtime.

Eshte derguar vendimi, date 27.05.2020 per ekspertimin mjeko-ligjor te kufoms, prane Institutit te Mjekesise Ligjore Tirane, per te zbuluar shkaku e vdekjes se te ndjerit Saimir Sula.

Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor Nr 540, dt 07.10.2020, mbi ekzaminimin e kufomes se shtetases Saimir Sula, eshte arritur ne konkluzionin se ;

Ne trupin e kufomes se shtetasit Sajmir Sula, ne kqyrjen e jashtme pervec prerejeve autoptike dhe ndryshimeve pas vdekjes nuk u vune re demtime te shkaktuara nga dhuna. Nga kqyrja e brendeshme e organeve dhe te dhenave mikroskopike nga ana jone u konstatuan; Bronkopneumoni sero- deskuamative. Aderenca pleurale ne anen e djathte te gjoksit. Hepatit Koronik persistent. Autolize e organeve. **Mungese e zemres.**

Ne mungese **te ekzaminimit te zemres**, i cili eshte nje organ jetik dhe i rendesishem nuk mund te percaktojme shkaku e vdekjes se viktimes me saktesi shkencore.

Ne gjakun e viktimes nuk u zbuluan metabolite te medikamentit haloperidol.

Gjatë hetimit, jane administruar dokumentat spitalore me procesverbalin kqyrje marrje te e dates 26.10.2020 , jane administruar dokumenta te vena ne dispozicion nga motra e te ndjerit shtetesja Majlinda Sula, si fotokopje e autopsise preliminare, jo definitive ne gjuhen Spanjolle, f otokopje e karteles klinike te pacientit Saimir Sula, marre prane spitalit Hospital Del Mar, me adrese "Passeig Maritim de la Barceloneta Nr 25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelone Spanje , ne Sanjshit , të cilat janë në gjuhën spanjolle

Në konkludim të kësaj analize pra mungeses se zemres, referuar aktit të ekspertimit mjeko ligjor Nr 540, dt 07.10.2020, mbi ekzaminimin e kufomes se shtetases Saimir Sula, lindin dyshime per kryerjen e vepres penale “*Shitblerja e paligjshme e organeve*” te parashikuar nga neni 89/a te Kodit Penal.

B.Teksti i dispozitave ligjore të zbatuara

Neni 89/a i Kodit Penal

“Shitblerja e paligjshme e organeve”

Shitblerja e transplanteve, si dhe çdo veprimtari që lidhet me heqjen dhe implantimin e paligjshëm të organeve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kjo vepër e kryer nga personi që shpërdoron pozitën e tij ndaj një fëmije ose një personi tjetër të pambrojtur, dënohet me burgim nga shtatë deri në dhjetë vjet.

Kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose në bashkëpunim, dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur nga vepra e mësipërme shkaktohet vdekja e viktimës ose kjo vepër kryhet nga grup i strukturuar kriminal ose organizatë kriminale dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet burgim.

Baza ligjore dhe ndihma e kërkuar

Persa me sipër, mbeshtetur ne nenin 509/1,2 te Kodit te Procedures Penale te Republikes se Shqiperise dhe nenin 15 te Konventes Evropiane “Per ndihme te ndersjellte juridike ne fushen penale”, ne interest e procedimit penal Nr 6607, date 09.10.2020, te Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, bazuar ne Parimin e Reciprocitetit dhe Vullnetin te mire te autoriteteve gjyqesore te Republikes se Spanjes, te procedoje me venie ne dispozicion te Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane , te akteve te meposhtme ;

1. Te administrohet akti i ekspertimit definitiv/perfundimtar i bere nga Autoritetet Spanjolle, per te ndjerin Saimir Sula, ne te cilin eshte pasqyruar shkaku i vdekjes se te ndjerit ne Spitalin Hospital Del Mar, me adrese “Passeig Maritim de la Barceloneta Nr 25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelone Spanje.
2. Te verifikohet dhe te administrohen dokumenta spitalore, duke filluar nga data 08.05.2020 dhe ne vazhdim per te ndjerin Saimir Sula, ne lidhje me arsyet e shtrimit/ hospitalizimit te ketij pacineti?
3. Te informohemi ne lidhje me arsyet e mungeses se zemres se te ndjerit Saimir Sula, referuar aktit te ekspertimit mjeko- ligjor Nr 540, dt 07.10.2020 te kryer nga I.M.L.Tirane, mbi ekzaminimin e kufomes se shtetases Saimir Sula.

4. Te komunikohet dhe te merret deklarim stafit/ personelit mjekesor te spitalit Hospital Del Mar, me adrese "Passeig Maritim de la Barceloneta Nr 25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelone Spanje, (*apo dhe spitaleve te tjera*), ne lidhje me arsyet e parqitjes ne urgjensen e spitalit me date 08.05.2020 te te ndjerit Saimir Sula, diagnozen e shtrimit dhe mjekimin e marre etj, si dhe cdo te dhene tjeter ne lidhje me pacientin Saimir Sula.
5. Te komunikohet dhe te merret deklarim Mjekes Irene Petit, qe ka komunikuar me shtetasen Majlinda Sula (*mota e te ndjerit*).
6. Te merren shpjegime Mjekes Psikiatre Ana Martin, qe ka ndjekur pacientin ndermjt Muajit Prill dhe Maj 2020, mjeke psikiatre prane Spitalit Sant Pau, ne Barcelone, Spanje, ne lidhje me diagnozen e pacientit si dhe cdo te dhene tjeter per kete pacient.
7. Te verifikohet se kush ka qene mjeku qe ka komunikuar ne telefon me motren e te ndjerit nga numri i spitalit 0034-649288801, rreth ores 12.08 min AM.
8. Te verifikohet se kush ka qene mjeku qe ka kontaktuar ne telefon oteren e te ndjerit Saimir Sula nga numri 0034-932209586, rreth ores 15.00?
9. Kerkojme nga ana juaj, te informohemi nese nga Autoritetet e Drejtese se Spanjolle, kane filluar hetime ne lidhje me rastin objekt hetimi nga ana jone? Nese po jeni te lutur te na vini ne dispozicion kopje te ketyre akteve?
10. Te kryhen hetime dhe verifikime ne lidhje me cdo dokumentacion tjeter qe cmohet i nevojshem ne lidhje me rastin objekt hetimi.

Theksojme se aktet dhe provat qe do te gumbullohen nga Autoritetet Spanjolle te na dergohen origjinale, nese ligji i autoritetit Spanjoll e lejon te jene origjinale ose fotokopje te vertetuara me orgjinalin.

Prokuroria e prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ju siguron autoriteteve gjyqesore te Spanjolle per nje bashkepunim (dyanshmeri) te plote.

Ne perfundim ju bejme me dije se nje pergjigje sa me e shpejte nga ana juaj do te shmangete zvarritjen e hetimeve.

Të dhënat e kontaktit

Për çdo informacion të mëtejshëm lidhur me këtë kërkesë, lutemi të (*mund të vendosni të dhënat e kontaktit që i shihni të arsyeshme*) kontaktoni me:

Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, në:
tel/fax: 00355 42 235232

Prokurori i çështjes

Emër Mbiemër: Suela SALAVAÇI

Adresa: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

Telefoni: +355694113457

E-mail: suela.salavaci@pp.gov.al

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje sa më të shpejtë.

PROKURORI I ÇËSHTJES
Suela SALAVAÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. _____ Prot / S.Salavaci

Tiranë, më ____ .01.2021

Lenda: Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar Autoriteteve Gjyqësore të Spanjes lidhur me procedimin penal Nr 6607, date 09.10.2020

MINISTRISË SË DREJTËSISË
*Drejtorisë së Përgjithshme të Jetësimi të Prioriteteve,
Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Integritimit
Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë*

TIRANË

Për dijeni:

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë

TIRANË

Mbështetur në nenin 15 të Konventës së Këshillit të Evropës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale, nenin 509 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 6 të Ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, ju përcjellim bashkëlidhur, me qëllim transmetimin autoriteteve të **Spanjolle**, kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të **procedimit penal nr.** nr.6607, date 09.10.2020, qe ben fjale per vepren penale te “Shitblerja e paligjshme e organeve ” parashikuar nga neni 89/a te Kodit Penal .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DRJETUESI I PROKURORISË
ELIZABETA IMERAJ
ME URDHER DHE DELEGIM
DREJTUESI I SEKSIONIT
GENCI QANA